



Nr. 738/24
Data 03.07.24

Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2224_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Vendimin V_1766_2023 të datës 21 shtator 2023, Vendimin V_1921_2023 të datës 22 mars 2024 për vazhdimin e afatit të aplikimit të tarifave, dhe kërkesën nr. prot. 240/24, datë 24.04.2024 të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., për aprovimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës dhe si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë,

në seancën e mbajtur më 01 korrik 2024 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** –Lista e Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë, të cilat do të jenë të aplikueshme deri shqyrtimin e ardhshëm të tarifave të ALPEX sh.a.
- II. OBLIGOHET** – Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX sh.a., që deri në aprovimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të ALPEX, tarifat e njëjta që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë do të aplikohen për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës.
- III.** Struktura e tarifave të ALPEX sipas këtij Vendimi për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), të cilat do të jenë të aplikueshme janë në tabelën në vijim:

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Ndërditorë	Vjetore	€ 8,000	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Ndërditorë	Ditore	€ 0.14	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Ndërditorë	Ditore	€ 0.04	Anëtari i Bursës

- IV.** Tarifat duhet të publikohen në faqen zyrtare të ueb-it www.alpex.al.
- V.** Ky vendim zbatohet për zonën ofertuese të Republikës së Kosovës deri në shqyrtimin e ardhshëm të tarifave të ALPEX që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë.



ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 24 prill 2024, nga Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX sh.a., ka pranuar kërkesën për miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë.
- ZRRE ka vlerësuar se përderisa Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a. është në proces Operacionalizimit të Tregut Ndërditorë, ka miratuar tarifat vetëm për aktivitetet si në vijim:
 - ✓ Shtimin e Tarifës Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Ndërditorë,
 - ✓ Shtimin e Tarifës Variabël të Tregtimit për MWh për Tregun Ndërditorë, dhe
 - ✓ Shtimin e Tarifës Variabël të Klerimit për MWh për Tregun Ndërditorë.
- ZRRE ka vlerësuar se, për sa i përket ndryshimeve të kërkuara në emërtimin e Tarifës Vjetore të Trajnimit në Tarifa e Trajnimit dhe Tarifës Vjetore të Provimit si dhe frekuencën e tarifave të trajnimit dhe provimit nga pagesë vjetore në pagesë vetëm një herë, këto ndryshime të jenë pjesë e tarifave të miratuara pas miratimit të Metodologjisë së Përcaktimit të Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- ZRRE vlerëson se duke marrë parasysh faktin që Metodologjia e përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është ende në proces miratimi, ku në zbatim Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, ZRRE duhet të bashkëpunojë me ERE për miratimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe Bashkimin e Tregjeve Shqipëri - Kosovë në Tregun Ndërditorë.
- ZRRE vlerëson se, tarifat e propozuara nga ALPEX sh.a të bazuara në benchmark-et me vendet e rajonit si CROPEX, IBEX, SEEPEX dhe EnExGroup, MEMO do të jenë të përkohshme dhe do të ndihmojnë mbulimin e mëtejshëm të kostove operacionale, deri në momentin e miratimit të tarifave mbështetur në Metodologjinë e përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Tarifat e aprovuara me Vendimin V_1766_2023 të datës 21 shtator 2023 dhe Vendimin V_1921_2023 të datës 22 mars 2024, vazhdojnë të zbatohen për zonën e ofertuese të Republikës së Kosovës, deri në shqyrtimin e ardhshëm të tarifave të ALPEX, sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës për miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që ndërlidhen me Tregun Ndërditorë, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.



- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- ALPEX,
- KOSTT, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.